


Krijohet grupi i punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e drejtës së votës shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Shqipërisë

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, i cili ka si qëllim hartimin e paketës ligjore për garantimin e drejtës së votës shqiptarëve në Diasporë. Grupi ndërinstitucional do të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të tij janë përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Instituti i Statistikave.



Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



Çdo qytetar shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, tanimë ka mundësi të adresojë shqetësimin e tij drejtpërdrejt në të gjitha nivelet drejtuese të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kjo falë rubrikës më të re "Raporto", e cila sapo është shtuar në platformën Ambasadalme.

- Për përdoruesit e iOS aplikacioni shkarkohet [këtu](#);
- Për përdoruesit e Android aplikacioni shkarkohet [këtu](#);



Sot, në mbledhjen e radhës me grupin ndërinstitucional të punës për zbatimin e urdhrin 180/2018 si pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 – 2024

U mbajt në Tiranë konferenca "Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore"



Këtë fundjavë u mbajt në Tiranë konferenca dy ditore "Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore". Një aktivitet i organizuar në Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe instituti Alb Shkenca me mbështetjen e ministrit të Shtetit për Diasporën. Në fjalën e tij përshëndetëse ministri Majko tha se kjo konferencë është një hap, si pjesë e bashkëpunimit me shoqërinë civile i cili me mbështetjen buxhetore të shtetit shqiptar do të jetë një aktivitet i përvitshëm. Ajo si e tillë ka një rëndësi të madhe për komunitetin e shkencetareve shqiptar brenda dhe jashtë vendit. Studuesit mbarëshqiptarë prezantuan punën e tyre kërkimore sipas fushës së studimit, në një nga pesë panelet: Konferenca e Shkencave të Filologjisë, Historisë dhe Kulturës; Konferenca e Shkencave Juridike, Ekonomike dhe Sociale; Konferenca e Shkencave të Bujqësisë; Konferenca e Shkencave të Natyrës dhe Mjedisit, si dhe Konferenca e Shkencave të Mjekësisë.



Fjala e plotë e ministrit në Konferencën "Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës Shkencore"

QBD në konferencën "Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore"

Qendra e Botimeve për Diasporën mori pjesë në konferencën dyditore "Kërkimi shkencor në hapësirën mbarëshqiptare dhe roli i Diasporës shkencore" që u organizua nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe instituti Alb Shkenca me mbështetjen e ministrit të Shtetit për Diasporën. Në kumtesën e saj "Gjuha shqipe në epokën digjitale", Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, duke sjellë në vëmendje situatën e shqipes në epokën digjitale, tha se përfshirja e shqipes në teknologjinë gjuhësore është tashmë një domosdoshmëri.



KKD / Mark Gjonaj vlerësohet me çmimin "Gentleman of Quality Award"



Këshilltari i Bashkisë së Nju-Jorkut, Mark Gjonaj është vlerësuar me çmimin "Gentleman of Quality Award" nga Dhoma e Biznesit të Grave në Nju-Jork, SHBA. Anëtar i KKD-së është vlerësuar për punën e tij në mbështetje të grave sipërmarrëse të komunitetit.

QBD/ Mbërrijnë librat falas në Rumani



Mbërritën në Rumani tekste të shkollara për mësimdhënien në Diasporë, të dërguara nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Postën Shqiptare. Shpërndarja e teksteve në të gjitha shkollat shqipe përkatëse do të bëhet në kujdesin e ambasadës shqiptare atje.

QBD/ Mbërrijnë librat falas në Greqi



Për herë të parë nxënësit shqiptarë të Diasporës në Greqi, nisnin vitin e ri shkollor më 1 tetor me tekste të dërguara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën me urimet dhe falenderimet e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi.

QBD/ Mbërrijnë librat falas në Itali



Nxënësit e shkollës shqipe në Trento, Itali përherë të parë këtë vit do të mësojnë me abetaret dhen tesktet shkollore të shpërndara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Staf i kësaj shkolle tërhoqi librat pranë Ambasadës Shqiptare në Romë.